



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

NrProt.

Shkoder, me ____/____/2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

[21.07.2026]

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ ose

[**JUBICA. me nipt K26529001I**, adresa: Luigj Gurakuqi, Kuklejt 108, Shkoder]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Pune

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur

Numri i procedurës / referenca: **REF 88114-05-29-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Objekti: Ndertim i rrjetit te KUZ per zonen e Shirokes dhe ndertim i rrjetit KUZ per zonen Zogaj, Bashkia Shkoder**

Fondi limit: 239,120,422 (Dyqind e tridhjetë e nente milion e njëqind e njëzet mijë e katërqind e njëzet e dy) leke pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 13.07.2026

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit

[Data]20.07.2026 [Numri] 46

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☒ X

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐ □

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit si më poshtë, vlera përkatëse të ofruara:

1. ALMO KONSTRUKSION

NIPT J91915001P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 223,701,511.9 (dyqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e një mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë pikë nëntë) lek pa tvsh, totali i pikeve të marra (Skualifikuar)

2. BE – IS SH.P.K

NIPT K71412003A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 226.178.308 (dyqind e njëzet gjashtë milion e njëqind shtatdhjetë tetë mijë e treqind tetë) lek pa tvsh, totali i pikeve të marra 253.50

3. CURRI

NIPT J67902718S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Vlera 218,589,379.39 (dyqind e tetëmbëdhjete milion e pesëqind e tetëdhjete e nente mijë e treqind e shtatëdhjete e nente pike tridhjetë e nente) lek pa tvsh, totali i pikeve të marra (Skualifikuar)

4. JUBICA.

NIPT K26529001I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 214,000,083 (dyqind e katërmëdhjetë milion e tetëdhjete e tre) lek pa tvsh, totali i pikeve të marra 274.50

5. "METEO".SH.p.k

NIPT L26310801C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 227,496,815 (dyqind e njëzet e shtatë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lek pa tvsh, totali i pikeve të marra (Skualifikuar)

6. B .O.E shoqëria NDREGJONI me NIPT K31329048I & shoqëria ASI-2A CO me NIPT K53002402C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 174,619,608 (njëqind e shtatëdhjete e katër milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tete) lek pa tvsh, totali i pikeve të marra (Skualifikuar)

7. PE - VLA - KU

NIPT K61716013M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 190,401,440.69 (njëqind e nëntëdhjetë milion e katërqind e një mijë e katërqind e dyzet pike gjashtëdhjetë e nente) lek pa tvsh, totali i pikeve të marra (Skualifikuar)

8. Progres Shkodra

NIPT M17324001D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: Nuk ka paraqitur oferte ekonomike. totali i pikeve të marra (Skualifikuar)

9. STERKAJ

NIPT J68310708M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 220,183,049.83 (dyqind e njëzet milionë e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyzet e nëntë pikë tetëdhjetë e tre) lek pa tvsh, totali i pikeve te marra (Skualifikuar)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, ofertuesit si më poshtë:

1. ALMO KONSTRUKSION

NIPT J91915001P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet si më poshtë:

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur në spe për këtë procedurë prokurimi rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi bazuar në kërkesën e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.2 gërma c) të kriterëve të vecanta të kualifikimit si më poshtë;

Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

Tuba HDPE RC

Tuba te brinjezuar SN8

Tuba rakorderi gize dhe saracineska gize

Mates uji me fllanxe

Pompa uji

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*
- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*
- *Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-*

2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: *Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.*

d) Për matësat e ujit

- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standardi i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.*
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.*

Nga verifikimi rezulton se ky operator nuk ka paraqitur asnjë prej katalogeve dhe autorizimeve të kërkuara në këtë pikë të kriterëve të veçanta.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu në vlerësim të deklarimeve të kryera në formularin përmbledhës të vetdeklarimit mbi disponueshmërinë e makineri paisjeve dhe stafit të kërkuar rezulton se operatori ekonomik ka mangësi për makineritë si vijon:

Konkretisht rezultojnë pa dokumentacion:

1. 4 kamionë vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton.
2. 4 kamionçina me kapacitet deri në 3.5 ton.
3. 1 autovinç me kapacitet mbi 1.5 ton.
4. 1 rimorkiator për transportin e makinerive.
5. 1 fabrikë betoni (në pronësi, me qira ose me kontratë furnizimi) – nuk rezulton të jetë paraqitur as kontratë furnizimi, as kontratë qiraje dhe as dokument pronësie.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm, nga verifikimi i Shtojcës Nr.8 Formulari i Vetdeklarimit konstatohet se këta inxhinierë janë të anagazhur edhe në kontrate tjerë të lidhur me AK.

Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohej për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të

disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- c) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.2.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret

specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët

ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[....]"

Në zbatim të legjislacionit të prokurimit public autoritetet kontraktor pranojnë si provë paraprake për të vërtetuar disponueshmërinë e kapaciteteve të operatorëve ekonomik në një procedurë prokurimi. Nga verifikimi rezulton se ky operator nuk plotëson makineritë e listuara si më lartë. Ndodhur në këto kushte operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e kualifikimit për këtë procedurë prokurimi.

Në vijim të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator rezulton se në përmbushje të punës së ngjashme operatori ekonomik ka paraqitur si me poshtë:

Kopshti zall mner 34,741,000

Rruga bathore, zall dardha dhe spahit 35,887,490

Rruga tom plezha 50,106,111

Kun bathore 1,481,200

Rruga miras arrez 41,758,550.55

Operatori ekonomik për përmbushjen e kriterit të kërkuar nga AK si më poshtë:

. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Nga vlerësimi I punëve të ngjashme të paraqitura operatori ekonomik nuk përmbush pikën a) të kriterit gjithashtu as pikën b) të saj, duke qënë se për plotësim të pikës a) operatori ekonomik duhet të paraqesi I punë të vetme në vlerën 50% të fondit limit ose 119,560,211 lek pa tvsh, ose në përmbushje të pikës b) duhet të paraqes disa kontrata në pesë vitet e fundit ku totali I tyre është jo më I vogël se dyfishi I fondit limit, ku qartazi nga përlogaritja e kryer ky operator nuk e plotëson këtë kriter.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s'kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e operatorit ekonomik shoqëria “ALMO Konstruksion” shpk me NPT J91915001P.

2. CURRI

NIPT J67902718S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet si me poshte:

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi rezulton se operatori ekonomik ka mangësi dokumentacioni si më poshtë:

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratë furnizimi nga subjekti “ADMIR DIDA” P.F, autorizimi I prodhuesit per distributorin është në gjuhë të huaj, dhe jo i përkthyer dhe noterizuar sic eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 gërma c).

Në vijim të vlerësimit të dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog për matësa uji me flanaxha sic ka kërkuar autoriteti kontraktor.

Gjithashtu përsa I përket **Tuba te brinjezuar SN8** rezulton se nga dokumentacioni i paraqitur mungojnë katalogët për këto materiale.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Përsa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor në këtë procedurë prokurimi.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e operatorit ekonomik shoqëria “CURRI” shpk me NIPT J67902718S.

3. “METEO”.SH.p.k

NIPT L26310801C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet si me poshte:

Komisioni në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik për këtë procedurë prokurimi, rezulton se ka mangësi në plotësimin e kushteve , si vijon:

Bazuar në formualrin e vetdeklarimit të paraqitur nga operatori rezulton se ka mangësi në staf dhe makinerite kërkuara si më poshtë:

Mungon

1 inxh hidroteknik

2 hidraulik

2 manovrator

2 kamioncina deri ne 3.5 ton

Makineri per ndertimin e mkirotuneleve horizontale nentokesore me system kontrolli Laser per ship, mikro-tunelesh

Përsa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriteret evecanata të kualifikimit

Në vijim të vlerësimit të dokumentacioni nga komsioni rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë autorizim apo karalog për pajisjet e kërkuara në pikën 2.3.2 gërma c) dhe d) si më poshtë:

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

Tuba HDPE RC

Tuba te brinjezuar SN8

Tuba rakorderi gize dhe saracineska gize

Mates uji me fllanxhe

Pompa uji

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*
- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*
- *Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: *Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.*

e) Për matësat e ujit

- *Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.*
- *Operatori Ekonomik të paraqesë certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s'kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s'kualifikimin e operatorit ekonomik shoqëria “METEO” shpk me NIPT L26310801C.

4. B .O.E shoqëria NDREGJONI me NIPT K31329048I & shoqëria ASI-2A CO me NIPT K53002402C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet si me poshte:

Komisioni i vlerësimit të ofertave në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik, operatori ASI-2A CO sh.p.k në deklarimin për stafin dhe makineritë nuk **1 (një) punonjës** të certifikuar me dëshmi trajnimi si **“Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”**.

Bazuar në Vendim Nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", operatorët ekonomik janë të detyruar që gjatë zhvillimit të punimeve në kantier të sigurojnë shëndetin dhe sigurinë në punë të punonjësve.

Në vijim të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik, pjesë e bashkimit të operatorëve, bazur në ndarjen e zërave të punimeve sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të paraqitur nga BOE rezulton se operatori ekonomik ASI-2A CO shpk ka marrë përsipër të realizojë punime gërmimi me

eksvator me zinxhir në një volum prej 5,077.70 m³ gërmime, dhe nga verifikimi i deklarimit për makineritë dhe paisjet që disponon ky operator ekonomik rezulton se nuk ka paraqitur një mjet të tillë.

Gjithashtu në vlerësim të zërave që ka marr përsipër rezulton se operatori ekonomik ka marr përsipër edhe zëra punimesh *Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik*, në një volum prej 7,828.12 m³, dhe nga verifikimi i deklarimit për makineritë dhe paisjet që disponon ky operator ekonomik rezulton se nuk ka paraqitur një mjet të tillë. (tokmak).

Theksojmë faktin se referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofetave sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit.

Qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 88 pika 3 e VKM nr.285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që secili nga operatorët e bashkimit të disponojë kapacitetet teknike profesionale në përputhje me përqindjen që kanë marrë përsipër të realizohet nga secili prej tyre. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve

në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në vlerësim të ndarjes së punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik ASI-2A CO shpk rezulton se volume e punime të mara përsipër nga ky operator janë gërmime dherash , duke

analizuar teknikisht proceset e punës lidhur me këto zëra, duke qënë se shtrirja e object zbatimit është e konsiderueshme dhe volume e gërmimit zënë një sasi dhe vlerë të konsideruar të vlerës së kontratës, komsioni vlerëson se ky operator ekonomik duhet të dispononte në stafin e tij për realizimin me sukses të kontratës inxh topograf.

Këto punime kërkojnë piketime topografike, kontroll të kuotave, kontroll të pjerrësive të tubacioneve dhe matje. Për rrjedhojë, anëtari i BOE që ka marrë përsipër këto zëra duhet të disponojë kapacitetin teknik për realizimin e tyre, përfshirë inxhinierin topograf.

Në marrëveshjen e bashkëpunimit rezulton se njëri prej anëtarëve ka marrë përsipër zërat e gërmimeve dhe të rrjetit të ujësjellësit, por nuk disponon stafin teknik ose makineritë e kërkuara për realizimin e këtyre punimeve, atëherë BOE nuk plotëson kërkesat e nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285/2021, pasi kapaciteti teknik nuk është në përputhje me natyrën e punimeve të marra përsipër.

Kërkesa për disponimin e një eskavatori me goma lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara, të cilat përfshijnë gërmime dheu në një volum prej rreth 5,077.70 m³. Kryerja e këtyre punimeve kërkon jo vetëm kapacitet mekanik të mjaftueshëm, por edhe zbatim të saktë të kuotave, profileve dhe koordinatave të projektit.

Në këtë kuadër, licenca **NP-18** mbulon punime që kërkojnë realizimin e gërmimeve dhe punimeve të tokës sipas standardeve teknike, ndërsa prania e një **inxhinieri topograf** është e domosdoshme për piketimin e objektit, përcaktimin e akseve, kuotave, profileve gjatësore e tërthore, kontrollin e volumeve të gërmimeve dhe verifikimin e zbatimit të projektit gjatë gjithë procesit të punimeve.

Eskavatori me goma, në bashkëveprim me drejtimin teknik të punimeve dhe kontrollin topografik, garanton realizimin e gërmimeve sipas parametrave të projektit, minimizon devijimet nga kuotat e projektuara dhe siguron saktësinë e volumeve të gërmuara, të cilat shërbejnë edhe si bazë për matjen dhe kolaudimin e punimeve.

Për rrjedhojë, ekziston një lidhje funksionale ndërmjet disponimit të pajisjes mekanike, licencës **NP-18** dhe angazhimit të inxhinierit topograf, pasi këto elemente së bashku garantojnë realizimin korrekt dhe në përputhje me kërkesat teknike të kontratës.

Ndodhur në këto kushte operatori ekonomik nuk plotëson kapacitetin Teknik bazuar në ndarjen e punimeve që ka marr përsipër.

Përsa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për këtë procedure prokurimi.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik shoqëria ‘NDREGJONI’ shpk me NIPT K31329048I, , & shoqëria “ASI-2A CO” shpk, me NIPT K53002402C.

5. PE - VLA - KU

NIPT K61716013M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet si më poshtë:

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton se në plotësim të pikës 2.3.2 gërma c) dhe d) ka paraqitur autorizime prodhuesi për materialet e kërkuar nga autoriteti kontraktor, por nga verifikimi i këtij dokumentacioni rezulton se operatori ekonomik autorizimet e prodhuesit nuk i ka të përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe sic është kërkuar nga autoriteti, si më poshtë:

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

Tuba HDPE RC

Tuba te brinjezuar SN8

Tuba rakorderi gize dhe saracineska gize

Mates uji me fllanxe

Pompa uji

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*

Për artikullin rakorderi gize, saracinesa gize, pompa uji operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori në gjuhën shqipe nga kompania “NOVAMAT” , ndërsa autorizimet e prodhuesit për distributorin është në gjuhë të huaj, ndodhur në këto kushte operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e kualifikimit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi, si më poshtë autorizimi i prodhuesit:





AUTHORIZED DISTRIBUTION AGREEMENT

SFA
41 bis avenue Bosquet,
75007 PARIS
France

hereby grants to

NOVAMAT shpk
Rruga "Ismail Qemali"
Pallati Samos Tower,
Kati 8të, Nr. 41,
Tirana, ALBANIA
VAT No.: K816150020
Represented by: Mr. Mehmet KRASNIQI, General Manager

The right to purchase, inventory, promote and resell "SFA products" within the territory of ALBANIA.
As used in the agreement, the term "SFA products" shall mean the products, related service parts and accessories manufactured and/ or sold by SFA as follows: SFA range.
This agreement is valid for 1 year and shall not be automatically renewed unless parties agree to in fixing the period of renewal.

Made in Paris, on the 22nd of May 2026
Elodie Meyer
Export Department

SFA
SOCIÉTÉ FRANÇAISE D'ASSAINISSEMENT
41 Bis avenue Bosquet - 75007 PARIS - France
SA au capital de 2.400.000 €
RCS PARIS 3 408 900 045
SIRET 3408 900 045 0003
VAT No.: K816150020
TEL: +33 1 44 69 39 23 FAX: +33 1 44 69 39 25
EMAIL: export@sfa.fr

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Përsa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor në këtë procedurë prokurimi.

Në vijim të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur, operatori ekonomik për plotësimin e stafit të kërkuar ka paraqitur formularin përmbledhës të vetdeklarimit, nga verifikimi I të cilit rezulton se ky operator nuk ka deklaruar inxhinir gjeoteknik sic është kërkuar në dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti Teknik pika 2.3.3 gërma c).

Komisioni i vlerësimit të ofertave skualifikon operatorin ekonomik duke qënë se nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e operatorit ekonomik shoqëria “PEVLAKU” shpk me NIPT K61716013M.

6. Progres Shkodra

NIPT M17324001D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet si me poshte:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion për procedurën e prokurimit object vlerësimi.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e operatorit ekonomik shoqëria “Progres Shkodra” shpk me NIPT M17324001D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet si me poshte:

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi rezulton se:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.

Në dokumentet standarde të tenderit, në seksionin:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

A. TË PËRGJITHSHME autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Në dokumentet standarde të tenderit, në seksionin 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël). Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë: Loti 1 _____ (shuma,monedha) Loti 2 _____ (shuma monedha)

Autoriteti/ Enti ontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor.

Autoriteti/Enti Kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën: i. garancisë bankare X ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente X

Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (shprehur në ditë)

Seksioni 4: Procedura III.2.3 Në dokumentet standarde të tenderit, në seksionin.

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët EkonomikëA. TË PËRGJITHSHME autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:

a) PAGESA nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit kontraktor

b) Garanci bankare

c) Garanci sigurimi Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave.

Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.” Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 83, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Neni 83 Sigurimi i ofertës

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës,

autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Komisioni vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e

nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kerkesave/ kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Në vijim të vlerësimit të dokumentacionit rezulton se:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizimet përkatëse të kërkuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 gërma c) dhe d) për materialet e kërkuara.

Operatori ekonomik ka mangesi në stafin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta të kualifikimit, si më poshtë:

Mungon:

1 Inxhinier Ndërtimi

1 Inxhinier Mekanik

1 Inxhinier Hidroteknik

1 Inxhinier Mjedis

1 Inxhinier Gjeoteknik

2 (dy) specialiste karpentier

1 (nje) specialist guri

1 (nje) inxhinier duhet te jete i pajisur me Certifikaten per Vleresimin ne Mjedis

1 (nje) inxhinier duhet te jete i pajisur diplome/Certifkim per vleresimin e materialeve

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton 4 (kater) copë

Kamionçina me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton 4 (kater) copë

Autovinc me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton 1 (një) copë

Rimorkiator per transportin e makinerive 1 (një) cope

Makineri per ndertimin e mkirotuneleve horizontale nentokesore me system kontrolli Laser per ship, mikro-tunelesh 1 (një) copë

Makineri per testimin e tubave HDPE	1 (një)copë
Prerese asflati/sharre asfalti	1 (një) copë
Aparaturë për bashkim tubacionesh me metoden Electro Fusion	1(një)copë
Saldatrice/motosaldatrice	1 (një) copë
Fabrike betoni (pronesi ose qera/ me kontrate furnizimi)	1 (një) copë

Përsa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e vecanata të kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i s'kualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s'kualifikimin e operatorit ekonomik shoqëria “STERKAJ” shpk me NIPT J68310708M.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**JUBICA. me nipt K26529001I**, adresa: Luigj Gurakuqi, Kukle 108, Shkoder], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 214,000,083 (dyqind e katërbëdhjetë milion e tetëdhjetë e tre) lek pa tvsh, totali i pikeve të marra 274.50 është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a*, adresa: *Lgja 3 Heronjte, Rruga 3 Heronjte, Shkoder* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO X

ADMINISTRATORI

BESMIR LSHA